

Jean-Luc Marion

Fenomeni erotik

(Gjashtë meditime)

HESHTJA E DASHURISE

Filozofia nuk thotë sot asgjë mbi dashurinë, ose fare pak. Por më mirë kjo heshtje sesa ta keqtrajtoshte apo tradhtosh atë, ashtu siç bën filozofia kur ajo ndërmerr për të folur mbi të. Pothuaj do të dyshonim që filozofët kanë njëfarë neverie kundrejt neverisë, nëse nuk do të zbulonim më parë që ato kanë frikë të mos thonë asgjë për të. Me të drejtë, sepse ato e dinë, më mirë se kushdo tjetër, që ne nuk kemi më fjalë për ta thënë atë, as koncepte për ta menduar, as forca për ta nderuar.

Filozofët e kanë braktisur atë në fakt, e kanë rrëzuar nga koncepti dhe përfundimisht e kanë flakur atë në anët e saj dytësore të errëta dhe shqetësuese të arsyes së tyre të mjaftueshme – me të ndrydhurën, të pathënë dhe të papohueshmen. Padyshim, diskutime të tjera pretendojnë ta theksojnë këtë braktisje dhe, sipas mënyrës së tyre, ia arrijnë nganjëherë. Poezia mund të ma thotë atë çka unë ndiej pa ditur ta shprehë atë në mënyrë të shkoqur dhe ajo më çliron kështu nga memecëria ime erotike – ajo nuk do të më bëjë megjithatë ta kuptoj ndonjëherë dashurinë në konceptin e saj. Romani ia arrin për të ndërprerë shurdhërinë e krizave të mia dashurore, sepse ai i fut ato në një rrëfyeshmëri të shoqërueshme, shumë të shumësore, publike – por ai nuk më shpjegon mua atë çka më ndodh, realisht, mua. Teologjia, ajo, e di atë për çka bëhet fjalë ; por ajo e di atë tepër mirë për të shmangur gjithmonë të më vendosë mua një interpretim aq të drejtpërdrejtë nga Pasioni, sa që ajo asgjëson pasionet e mia – pa marrë mundimin për tu dhënë të drejtën fenomenalitetit të tyre, dhe as dhënë një kuptim brendësisë së tyre.

Mbi një thjeshtim rrënjësor

§ 1. Të dyshosh mbi sigurinë

Të gjithë njerëzit dëshirojnë të njohin, asnjë nuk dëshiron të mos dijë. Ndërmjet të mos dish dhe të dish, asnjë nuk nguron të parapëlqejë të dytën. E përse? Tekefundit, shtënia në dorë e dijes – më thjesht, e një dije – kërkon vëmendje, mundim dhe kohë, në atë pikë që shpesh do të donim t'i shmangeshim kësaj me qejf. Mirëpo, në fakt, ne nuk veprojmë kështu. Përse pra, përse parapëlqejmë ne, edhe duke pranuar vështirësinë, për të ditur sesa për të mos ditur?

Një përgjigje e parë na thotë që ne dëshirojmë të dimë thjesht për kënaqësinë e të njohurit – ndoshta kënaqësia më ngacmuese, më e qëndrueshme dhe më e pastër ndër të gjitha kënaqësitë që ne mund të kemi në këtë jetë. Në atë pikë që këtu kemi mundur të shohim të vetmen paqësi të natyrshme të mundshme, rivale e tjetrës, së pakushtëzuar. Por, qysh të mos shihet që, në këtë rast, ne nuk dëshirojmë të njohim thjesht për të njohur, por për të provuar kënaqësinë e të njohurit – ne njohim për t'iu gëzuar njohjes, për t'iu gëzuar aktit të të njohurit, pra, përfundimisht, për t'iu gëzuar vetes sonë përmes procesit të të njohurit. Pra ne nuk dëshirojmë të njohim, por për t'iu gëzuar vetes sonë. Njohja kthehet aty mjet i thjeshtë, sidoqë më efikas dhe më ekonomik, i një gëzimi të tillë të vetes sonë. Më thelbësore sesa dëshira për të njohur, ia beh vetë dëshira. Dëshirë e cila nuk dëshiron tjetër, edhe në njohjen, përveçse gëzimin e vetes.

Ndaj kësaj përparësie të dëshirës për t'iu gëzuar njohjes, ne mund të bëjmë përnjëherë këtë vërejtje: edhe pse njohja na mbush nganjëherë deri në kënaqësi, kjo nuk ndodh gjithmonë kështu. Së pari sepse njohja mund të dështojë për të na zbuluar të vërtetën, ose, më keq akoma, ajo mund të na lerë në iluzionin e të paturit zbuluar këtë të vërtetë. Pastaj sepse me tu njohur me këtë të vërtetë, ndodh që kjo njohje të na plagosë dhe të na shqetësojë edhe më tepër. Do të pranojmë që, në këtë rast, ne nuk njohim për kënaqësinë e të njohurit, aq më pak për t'iu gëzuar vetes sonë në këtë akt të njohuri – pasiqë përkundrazi ne vuajmë nga kjo. A rrjedh nga këtë megjithatë që, kur ne njohim edhe atë që na plagos apo na shqetëson, ne dëshirojmë të njohim për të njohur? Asgjë nuk është më pak e sigurtë: sepse përse pranojmë ne që vlen më mirë të marrim përsipër rrezikun për të ditur të vërtetën, edhe pse jo e mirëseardhur, sesa të mos dimë asgjë prej gjëje? Për një arsye të dukshme: të njohësh një gjendje faktike

potencialisht të dëmshme për mua, kjo më lejon ose t'i ruhem asaj, ose të paktën ta parashikoj ; të njohësh, dhe sidomos atë që kërcënon, kjo prek sigurimin e atij që njeh, dmth ruajtjen e vetes. Sigurisht që dëshira për të njohur drejtohet mbi të njohurën apo të njohshmen – por para së gjithash dhe përfundimisht në dobi të njohësit. Edhe më thelbësore sesa dëshira për të njohur është, tek ai, dëshira për të ruajtur veten e tij, dmth për t'iu gëzuar vetes.

Ne dëshirojmë pra më tepër të dimë sesa të mos dimë, e megjithatë kjo dëshirë nuk sillet mbi atë çka ne njohim, por mbi ne që njohim. Dhe këtu bëhet fjalë veçse për dukjen e një paradoksi, pasi që atë e gjejmë në përkufizimin më klasik të shkencës – quajmë shkencë një njohuri të sigurtë. Lindja e sigurisë tregon këtu që nuk mjafton të njohim për të njohur në nivelin e arsyes, në përputhje me një shkencë : shkenca e arrin sigurinë e vet veçse duke dalluar midis gjërave atë çka mund të thjeshtohet në përhershmëri (nëpërmjet modelesh dhe parametrash, riprodhim dhe prodhim) dhe atë çka nuk mundet kështu. Nga ky dallim rrjedh, nga njëra anë, objekti – e njohura e tillë si e siguruar, si e sigurtë për atë që njeh ; dhe nga ana tjetër, e paobjektivueshmja (ajo që nuk kthehet në një objekt) – ajo çka në gjënë në fjalë qëndron në vete dhe nuk i kënaq kushtet e njohjes, shkurt e dyshimta. Ndërmjet së sigurtës dhe së dyshimtës, ndërmjet objektit dhe së paobjektivueshmes, kush e cakton kufirin ? Ai që njeh, *egoja* – shprehja *unë* e cila ndan atë çka do të kthehet objekt për të dhe atë çka nuk do të kthehet e tillë dhe do t'i shpëtojë asaj. Siguria tregon pra vajtjen nga e njohura (dhe, negativisht, nga e panjohshmja) tek *egoja*, në atë mënyrë që, në njohjen e objektit, më shumë sesa për këtë objekt, bëhet fjalë për *egon* që e objektivon atë, që e ngre atë në këmbë dhe mirëfilli e jep atë si të sigurtë. Natyrisht, objekti shndrit nga siguria, por kjo siguri nuk do të kishte asnjë kuptim nëse ajo nuk do t'i përgjigjej *egos*, e cila vetëm ajo e sheh dhe e vendos këtë siguri. Objekti ia detyron sigurinë e vet – certifikatën e vet – *egos* që e jep atë si të sigurtë. Në objektin e sigurtë tregohet në fakt dhe në të drejtë së pari ai që jep si të sigurtë atë. Edhe me njohjen e sigurtë të objektit, edhe në regjimin e sigurisë, dëshira për të njohur futet përsëri tek gëzimi i vetes. Të konstituosh objektin, kjo më bën t'i gëzohem, nëpërmjet tij, vetes sime. Kështu përcaktimi i së vërtetës nëpërmjet sigurisë vërteton atë çka dëshira për të njohur linte tashmë për tu dukur : në çdo njohje, bëhet fjalë, tekefundit, për gëzimin e vetes. Nga këtej do të duhej të rridhte pra që çdo dëshirë për të njohur bën për të njohur më mirë atë që njeh sesa atë çka ky i fundit njeh ; ose që çdo njohje e sigurtë objekti na jep sigurinë e *egos* që vendos sigurinë e këtij objekti.

Megjithatë, kjo dukshmëri e sigurisë duhet vënë në dyshim. Ose më mirë, duhet dyshuar që siguria e objekteve të dhëna si të sigurta të mund të rikthehet mbrapsht, në të njëjtin kuptim, deri tek *egoja* që vendos këtë siguri të tyren. Njëkuptimësia e sigurisë nuk ka asgjë të sigurtë. Sepse, edhe nëse një siguri unike do të drejtonte *egon* dhe objektet e saj, *egoja* do të shpëtonte që aty përsëri, nëse ajo do të duhej të ndeshte një dyshim krejt tjetër sesa ai që të cilin siguria lejon për ta zhdukur. Këtë e vërtetojnë mjaft argumente.

Së pari, mund të mendohemi mbi shtrirjen e fushës së sigurisë. Të japësh një objekt si të sigurtë do të thotë ta mbash atë plotësisht të zotëruar nën ruajtjen e vështirimit tënd (*in-tueri*). Ta mbash kështu nën ruajtje nënkupton të mundësh për ta konstituuar dhe rikonstituuar atë, pasi që ai të jetë analizuar pjesë-pjesë, secila prej tyre duke qenë mjaft e qartë dhe e shquar për që vështirimi ta

mbërthejë atë qartësisht, jo të turbullt. Objekti i ofrohet sigurisë vetëm i thjeshtuar kështu në pjesëzat e tij të dukshme. Pra duhet filluar nga objektet më të thjeshta – ato të cilat trajtohen nga matematika (e cila nuk kërkon asgjë më tepër sesa intuitën e hapësirës së kulluar), ose nga logjika (që nuk kërkon asgjë tjetër përveç mos-kundërshtimit). Po kështu ndodh dhe me objektet e prodhuara në seri teknika (ku identiteti formal nuk kërkon gjë tjetër përveçse një formë abstrakte, plan ose « koncept » dhe një lëndë të kthyer material homogjen). Objekte të tilla – një ekuacion, një parashtrim logjik dhe një produkt industrial – ofrojnë sigurisht një « cilësi të plotë » dhe meritojnë të cilësohen si *të sigurta*. Por vetëm fenomene kaq të varfëra në intuitë mund të zbulohen kaq të pasura në siguri.

Mirëpo pikërisht, ç'më hyn në punë kjo siguri këtu ? Përse do ta vlerësoja unë atë kaq lart ? A është e vetëkuptueshme që nevoja ime për tu siguruar të mund të kënaqet nga siguria e fenomeneve të varfëra ? Sepse tekefundit një siguri e tillë ka lidhje vetëm me *objekte*, të cilat sillen ndaj meje pikërisht si të paqena unë dhe as si unë. Qysh jam unë në fakt ? Unë jam sipas *mishit* tim. Në kundërshtim me abstraksionin formal i cili bën objektet, mishi im e lë veten të preket papushim nga gjërat e botës ; dhe ai e bën këtë vetëm ngaqë ai zbulohet në vetvete i prekshëm, pra i prekshëm së pari nga vetja dhe në vetvete. Ai më ofron kështu ndaj vetes sime si një fenomen, ku tufa e intuitave kapërcen gjithmonë dhe së largu sigurinë e formave që unë nuk do të mundja kurrë tu caktoja atyre, si dhe kuptueshmërinë e qëllimësive që unë nuk do të mundesha t'i lexoja kurrë. Ndërmjet këtij fenomeni të përplotë (mishi im) dhe fenomeneve të varfëra të objektësisë, thellohet një e çarë përfundimtare. Paradoksalisht, siguria e tyre, në vetë momentin që unë e shti në dorë atë, nuk më intereson më : ajo ka të bëjë vetëm me përdorimin e fenomeneve të një tipi tjetër sesa i imi, por aspak me mënyrën time të mirëfilltë, dhe as me vetëqenësinë unike të mishit tim, të padukshme, të padhënshe si e sigurtë.

Së dyti, mund të pyesim *a contrario* : ç'do të fitonte kjo *ego*, nëse do t'i jepnim asaj pa e diskutuar sigurinë e objekteve të dhëna si të sigurta ? Le të supozojmë të fituar argumentin kanonik : egoja arrin fare mirë një siguri, madje më të madhen, sepse, siç e dimë, edhe dhe sidomos nëse ajo mashtrohet mbi dukjet më të pastra, për shembull mbi ekzistencën apo mendimin e saj të vet, duhet akoma që ajo të jetë, le të qe kjo vetëm për tu mashtruar kështu. Dhe sa më shumë që mashtrohem (apo jam i mashtruar), aq më shumë unë jam, sepse, për tu mashtruar (apo të jem i mashtruar), duhet së pari dhe sidomos të mendoj – mirëpo të menduarit mpleks të vepruarit e një akti, një akt i cili dëshmon të qenurit. Pa asnjë dyshim, egoja arrin kështu *një* siguri. Sigurisht, por cilën ? Ja çështja jonë. Egoja ka një siguri, një të vetme – atë të të mbeturit e pranishme po aq gjatë dhe çdo herë që ajo do të mendojë. Që ajo do të mendojë çfarë ? Që, për tu mashtruar apo qenë i mashtruar, duhet menduar, pra qenë. Unë do të jem kështu në masën e saktë ku unë kryej një akt – në fakt një akt mendimi, sepse unë nuk vendos për asnjë akt tjetër, në këtë moment – dhe kuptohet që unë do ta kryej këtë akt në të tashmen, çast pas çasti, po aq gjatë që unë do të mendoj(hem). Sigurisht, ja pikërisht një siguri. E megjithatë, e njëjta çështje rikthehet përsëri : kjo siguri, në çfarë më siguron ajo në një mënyrë tjetër sesa ajo e objekteve që unë vetë i qartësoj ? Siguria, që unë e ndaj me objektet që unë qartësoj, a mundet ajo të më qartësojë mua si të tillë, dmth si kushti i mundësisë

së objekteve ? Dhe nëse unë jam i sigurtë veçse sipas mënyrës së objekteve, a jam bërë unë një objekt apo siguria dyfishohet ?

Duke e kthyer përmbys çështjen, do të mund të pyesnim akoma : mbi çfarë nuk mundem unë më të dyshoj ? Unë nuk mund të dyshoj më mbi këtë – që unë te jem në çastin ku unë mendoj që unë jam dhe që të jem po aq shpesh që unë e përsëris këtë çast. Por pikërisht, edhe për një objekt të qartësuar, unë nuk mund të dyshoj që ai të jetë çdo herë dhe po aq gjatë që unë e mendoj atë : nëse unë arrij ta mendoj atë, ai është, të paktën me të drejtë objekti të menduar (në mos si qenie autonome). Unë jam pra i sigurtë vetëm ashtu siç janë të tilla objektet e mia : në çastin e tanishëm, çast pas çasti, pa garanci ardhmërie. – Do të bëjmë vërejtjen që mbetet akoma megjithatë një ndryshim : objekti mund të mos ofrohet gjithnjë për tu menduar, ndërsa unë, unë mundem gjithmonë për ta menduar veten, pasi që te menduarit varet vetëm prej meje. Kjo vërejtje nuk vlen, sepse vdekja do të përfundojë së ndërpreri aftësinë time për ta menduar veten, ashtu siç ndodhitë e rastësishme të gjërave do të përfundojnë së asgjësuarit objektin. Unë nuk jam pra i sigurtë për veten përveçse njëllë siç dhe jam për objektin : nuk dyshoj që të jem gjallë dhe, megjithatë, që të jem. Nuk mbetet më përveçse një alternativë. Ose unë jam i sigurtë për veten, ngaqë e mendoj veten time ; por atëherë unë bëhem objekt i vetvetes dhe nuk marr tjetër përveçse një siguri objekti. Unë i mungoj pra vetes time si *ego*. Ose pranoj që *unë* jam i sigurtë mbi objektin e vetvetes dhe pra që vetë ky *unë* nuk është më objekti mbi të cilin ai është i sigurtë, thjesht ngaqë siguria e merr vulën e saj gjithmonë nga një tjetër ; kjo *unë*, e cila i qartëson vetes ekzistencën e një uni të kthyer në objekt, është tjetër sesa ky unë. *Unë* është tjetër sesa uni dhe siguria e unit objekt nuk e arrin këtë *unë* që unë jam.

Nga ku kemi një argument të tretë : me të qenë i sigurtë që ekzistoj, atëherë unë mund të dyshoj vërtetë për mua. Dhe na fakt, unë që jam i sigurtë të jem, unë nuk kam pushuar kurrë së dyshuari mbi mua. Mbi çfarë kam dyshuar ? Sigurisht jo mbi faktësinë time, as mbi qenien time gjallë në prani, as dhe mbi gëzimin tim të vetes në çastin – ato më janë dukur gjithmonë të fituara deri në provën e së kundërtës, të ripohuara çdo ditë pa u preokupuar mbi këtë. Kam dyshuar gjatë dhe ndryshe – mbi mundësinë dhe ardhmërinë time. Kështu unë kam mësuar të dyshoj mbi talentet e mia dhe mbi forcën e dëshirave të mia. Kam besuar për kohë të gjatë të bëhem një lojtar i madh futbollit, pastaj, më seriozisht akoma, një vrapues shumë i mirë i 1500 metrave. Kam besuar për shumë kohë, fëmijë, që nuk isha i lumtur, ndërkohë që unë isha i tillë ; pastaj, gjysmë i rritur, që do të isha i lumtur, ndërkohë që bëja gjithçka për të mos qenë ashtu. Kam besuar, më vonë, që sukseset do të siguronin mbi veten time, pastaj, duke i mbledhur ato, kam parë padomethënien e tyre dhe jam rikthyer tek pasiguria ime e fillimit. Kam besuar vetvetiu të gjitha premtimet dhe pohimet që më thonin të më donin dhe, edhe sot që i kam rënë paksa në të, në pamje të parë unë i besoj ato akoma ; por ndarjet e zakonshme, dështimet dhe lodhjet e mia më kanë mësuar më në fund të dyshoj megjithatë mbi to. Pa asnjë kënaqësi të veçantë, sidomos pa atë të të qenurit rritur në urtësi apo në karakter, unë shoh aty provat e besimit tim të paktë dhe të marrëzisë sime. Përmbytja e mëparshme e të mundshmeve të mia të humbura më ka mësuar skepticizmin. Por tërë ky skepticizëm i shtrënguar dhe i detyruar nuk më ngazëllen aspak, as tek të tjerët as tek unë : ai nuk kërkon asnjë forcë mendore, thjesht dobësi dhe pak

mendjekthjelltësi për ta pranuar këtë ; dhe nuk ka vend për tu mburrur me pafuqinë dhe dështimet tona. Por një skepticizëm i tillë – ai në të cilin bie çdo fat i ngarkuar me rëndësinë e tij të vet – na mëson megjithatë një dukje : ne mundemi akoma për të dyshuar, për kohë të gjatë dhe rrënjësisht, edhe pse objektet e njohura na janë tashmë të sigurta, edhe pse *egoja*, e cila tek ne i njeh ato, është gjithashtu e tillë.

Si mundem unë të dyshoj mbi veten time, nëse unë jam i sigurtë të ekzistoj ? Nga ku vjen ky dyshim mbi vetë mua, nëse siguria ime e të ekzistuarit nuk mjafton për ta ndaluar atë ? Deri ku ushtrohet dyshimi im, kur ai dyfishon pa të keq sigurinë time të të ekzistuarit ? A do të mundej që dyshimi mbi mua të shpaloset përtej fushës së mbyllur të ekzistencës së sigurtë ? Tekefundit, ndoshta dyshimi nuk punon për të prodhuar sigurinë, por për ta tajkaluar atë.

§ 2. « E për çfarë më hyn në punë ? »

Mendimi metafizik çmon të ketë përmbushur të gjitha detyrat e tij spekulative duke na dhënë neve një siguri, madje duke na premtuar tërë sigurinë e mendueshme. Metafizika e sheh veten të kryejë një arritje të shkëlqyer duke prekur sigurinë e objektit, për ta zgjeruar atë më pas edhe ndaj *egos*. Mirëpo kjo kryerje nuk dëshmon tjetër përveçse verbimin e saj.

Në fakt, metafizika nuk e mban premtimin e vet, sepse ajo nuk na jep tjetër siguri, në më të mirën e rasteve, përveçse atë të objekteve (madje të disa objekteve), siguri e cila pikërisht nuk ka të bëjë fare me ne (të paktën me mua, që nuk jam një objekt), sepse ajo kalon nën heshtje sigurinë që ka rëndësi për mua – ajo e cila ka të bëjë pikërisht me atë që ka rëndësi më tepër për *mua*, veten *time*. Produktet e teknikës dhe objektet e shkencave, parashtrimet e logjikës dhe të vërtetat e filozofisë mund t'i gëzohen fare mirë tërë sigurisë së botës, po unë ç'lidhje kam këtu – *unë* që nuk jam as një produkt i teknikës, as një objekt i shkencës, as një parashtrim logjik, as një e vërtetë filozofike ? Hetimi i vetëm, rezultati i të cilit ka rëndësi vërtetë për *mua*, do të merrej me mundësinë e të vendosurit ndonjë siguri mbi identitetin, statutin, historinë, fatin, vdekjen, lindjen dhe mishin tim, shkurt mbi vetëqenësinë time të pathjeshtueshme. Nuk do të duhej t'i qortonim metafizikës dhe as shkencave që e lakojnë atë të arriturit në më shumë pasiguri sesa siguri – tekefundit, ato kanë bërë çka ato mundeshin dhe shprehin keqardhje më shumë se kushdo për paqartësinë e rezultateve të tyre. Dhe nuk mund t'ua tërheqim veshin atyre për të patur kufizuar gjithmonë kërkimin e urtësisë tek hetimi mbi të vërtetën dhe hetimin mbi të vërtetën tek mbërthimi i sigurisë – tekefundit asgjë nuk ka prodhuar aq rezultate objektive sesa ky kufizim i dyfishtë ; dhe shihet lehtë që prestigji i tyre të joshë. Por ne duhet t'i qortojmë ato me të drejtë për të mos paturit synuar ndonjëherë gjë tjetër përveçse një siguri dytësore dhe të prejardhur, të huaj dhe me qëllim të kotë (atë të objekteve, të njohurive të tyre, prodhim dhe përdorim), duke lënë pas dore apo shpërfillur sigurinë e vetme që ka të bëjë me mua, sigurinë mbi mua.

Sepse siguria, edhe siguria e thjeshtuar tek objektet që unë nuk jam, nuk mbetet e pacënuar nga çdo dyshim : ajo hapet përballë një kundër-prove e cila mund ta fshijë atë aq më tepër që aty nuk kundërshtojmë vlefshmërinë e saj

bazë. Mjafton që unë t'i bëj kësaj sigurie një pyetje të thjeshtë – « E për çfarë më hyn në punë ? ». Përlllogaritja logjike, operacionet matematike, modelet e objektit dhe teknikat e saj të prodhimit ofrojnë një siguri të përkryer, një « cilësi të plotë » - e pastaj ? Në çka më përket mua kjo, në mos për aq sa unë jam i futur në botën e tyre dhe që e nënshkruaj veten në hapësirën e tyre ? Meqë unë qëndroj megjithatë tjetër, ndryshe dhe gjetkë sesa ato, shkëmbimet tona i rregullon një kufi poroz : unë ndërhyj në botën e objekteve të sigurta, por unë nuk jam aty i ngujuar, pasi që unë kam privilegjin e tmerrshëm për t'iu hapur atyre një botë që, pa mua, ato nuk do ta fitonin nga vetvetja. Siguria e tyre nuk ka të bëjë me mua, sepse unë e banoj botën e tyre veçse si kalimtar, duke u sjellur aty herë pas here si pronari që vjen për të parë – por që jeton gjetkë. Pra, unë mundem – ose më mirë, unë nuk mundem të mos – provoj përkundrajt kësaj sigurie të një bote tjetër (në fakt të botës që unë nuk jam i saj) tonalitetin e pashtypshëm të kotësisë së saj : kjo siguri e kotë, me supozimin që të mund ta arrijmë atë, nuk ka fare rëndësi për mua, nuk ka të bëjë me mua, as nuk më prek, mua që nuk jam – i botës së tyre. Në një gjuhë të rëndomtë, do të themi që përparimi shkencor nuk përmirëson as jetën time, as aftësinë time për të jetuar mirë, as njohjen time të vetvetes. Në gjuhën konceptuale, do të mendojmë që siguria ndërbotësore nuk vendos asgjë në lidhje me *egon*, e cila e vetme e hap këtë botë ndaj objekteve, ndaj qënieve dhe ndaj fenomeneve. Me sigurinë e botës së qënieve ndodh siç me « thirrjen e qenies » - ato më prekin vetëm nëse unë e dua këtë ; mirëpo, meqë ato nuk më prekin në fakt dhe në të drejtë aspak në veprat e mia të gjalla, meqë ato nuk më thonë asgjë (asgjë mbi mua), unë nuk kam asnjë motiv për tu interesuar aty dhe as për tu futur midis tyre. Unë i lë ato pra tek vetja e tyre dhe ato bien pre e shpërfilljes, e verdiktit të kotësisë. Kotësia fshin sigurinë e objekteve, të cilat, sigurisht, mbeten të sigurta dhe të qarta. Por kjo qartësi nuk më siguron për asgjë mua, ajo nuk më vërteton asgjë. Siguri e kotë dhe e sigurtë.

Por, do të përgjigjemi neve, metafizika e ka kuptuar mirë këtë, metafizikë e cila ia ka dalë mbanë të zgjerojë sigurinë e gjërave të botës tek *egoja*, ego e cila bën hapjen aty vetëm sepse ajo veçohet që andej. Asgjë më e sigurtë sesa ekzistenca ime, me kusht dhe po aq shpesh që unë e shqiptoj dhe e mendoj atë. Siguria e botës mund të errësohet fare mirë, sa më shumë ajo shembet, aq më shumë unë që e hedh poshte atë e mendoj veten dhe pra jam sigurisht. Kjo përgjigje vërteton natyrisht sigurinë e *egos*, por gjithmonë në kotësi të plotë, pasi që ajo kufizohet për të zgjeruar tek *egoja*, megjithëse e huaj ndaj botës së tyre, të njëjtin tip sigurie siç ajo që u përshtatet objekteve dhe qënieve ndërbotësore. Sepse, që unë të jem i sigurtë si ato, madje më shumë se ato, çfarë lidhje ka kjo me mua ? Kjo siguri e të ngulmuarit në ekzistencë, kur dhe po aq kohë sa unë e dua këtë, nuk më vjen ndryshe përveçse si një pasojë e mendimit tim, si një nga produktet e mia, si *përftimi* im i parë – *përftimi* par excellence, sepse ai vë në lëvizje artin tim më origjinal, *cogitatio*-n time ; pra kjo siguri nuk është zanafilllore për mua, por ajo rrjedh nga *cogitatio*, e cila e vetmja siguron që unë jam kur unë dua t'ia siguroj këtë vetes. Gjithçka varet pra nga ajo çka unë mendoj – nga vullneti im mendues. Unë jam sepse unë mund të dyshoj mbi objektet dhe sepse e mendoj veten time duke dashur të dyshoj ; shkurt, unë jam i sigurtë sepse unë e dua këtë. Mirëpo ajo çka unë dua, a nuk mundem unë dhe të mos e dua ? Dhe ajo çka dua, a jam i sigurtë që ta dëshiroj atë gjithmonë e përsëri ? Meqë bëhet fjalë për një vendim të pastër të *cogitatio*-s, a nuk mundem

unë të përgjigjem « e ç'më hyn në punë ? » përballë mundësisë së të prodhuarit të sigurisë sime të mirëfilltë të të qenurit ? Çfarë arsye e sigurtë më siguron mua të dua papushim, dhe pa mëdyshje vetë këtë siguri ? Çfarë motivi absolutisht të patundshëm kam unë për tu përfutur në siguri, me tepër sesa jo ? Përse, tekefundit, të mos duash për të mos qenë sesa për të qenë ? Askush, sot në epokën tonë që është ajo e nihilizmit, nuk e merr këtë çështje për një gjë të tepruar. Prapa dukshmërisë së *cogitatio*-s së vetes nxjerr krye pra hija e një vendimi – ai për të prodhuar ose jo sigurinë time. Këtu ushtrohet pa u kundërshtuar pyetja « e për çfarë më duhet ? ». Siguria e *cogitatio*-s nuk ringjitet deri në origjinë, të cilën e zë vetëm një vendim më fillestar ; vetë ky vendim ofron veçse një siguri, të cilën mund ta fshijë gjithmonë kotësia.

Veç kësaj, një siguri që unë mundem (ose jo) ta prodhoj sipas dëshirës, a nuk mbetet ajo thelbësisht e rastësishme, e prejardhur dhe pra e huaj edhe ndaj meje ? Nëse siguria ime varet prej meje, vetë kjo siguri, të cilën unë duhet ta vendos, nuk mundet aspak të më sigurojë, pasi që, edhe e kryer, ajo nuk ka për origjinë tjetër përveçse mua – këtë mua që ajo do të duhej nga ana e saj ta siguronte. Ose bëhet fjalë për një vetë-themelim, pra për një rreth logjik të dënuar për të imituar pa sukses *la causa sui* e supozuar hyjnor (ky vetë tashmë i pambajtshëm) ; ose bëhet fjalë për një gjysëm-themelim, për një ngjarje empirike me pretendim trashendantal, të cilën kohësia e ripërcjell gjithmonë tek rastësia e saj e pandreqshme. Kjo siguri e supozuar e para shënon përkundrazi një shmangie të pakapërcyeshme ndërmjet, nga njëra anë, asaj çka mbetet në domenin tim, unë pa tjetër siguri sesa veten time, dhe, nga ana tjetër, asaj që e vetmja ajo do të mundej të më siguronte mbi mua – dmth një siguri e cila të më vijë nga gjetkë, më e hershme sesa unë. Ose unë jam nga vetëm nga vetja ime, por siguria ime është zanafillore ; ose siguria ime është zanafillore, por ajo nuk vjen nga unë. Siguria e vetes mund ta shpallë veten po aq fort dhe lart sa ajo do, por ajo shfaqet përfundimisht gjithmonë e përkohshme, në pritjen e pashpresë të një principi tjetër, i cili do ta siguronte atë më të vërtetë. Një ndihmë e tillë metafizike pohon fare mirë pafuqinë e çdo sigurie vetëvendosëse për ta siguruar veten plotësisht.

Asgjë nuk më shfaq pra më shumë ndaj sulmit të kotësisë sesa vërtetimi metafizik i ekzistencës së *egos*, sesa pretendimi im për të qenë i sigurtë me të drejtë *egoje*. Siguria dëshmon dështimin e vet në vetë çastin e daljes mbanë të saj : unë fitoj fare mirë një siguri, por, siç dhe ajo e qënieve të botës të qartësuar nga përkujdesjet e mia, ajo më dërgon tek iniciativa ime, pra tek unë, punëtor arbitrar i çdo sigurie, edhe i simes. Të prodhuarit vetë unë sigurinë time nuk më siguron në asgjë, por më tmerron përpara kotësisë dora vetë. E për çfarë më hyn në punë siguria ime, nëse ajo varet akoma nga unë, nëse unë nuk jam nga tjetër përveçse prej meje ?

§ 3. Thjeshtimi erotik

Kotësia fshin pra çdo siguri, qoftë mbi botën qoftë mbi vetë mua. A duhet hequr dorë megjithatë për tu siguruar mbi veten, për tu siguruar kundër çdo sulmi të kotësisë ? Pafuqia për t'iu përgjigjur pyetjes « për çfarë më duhet ? », madje thjesht për ta duruar atë, a nuk ilustron kjo kotësinë par excellence të

pamëshirshme të kotësisë ? Asgjë nuk i reziston kotësisë, pasi që ajo mundet akoma të shmangë dhe të fshijë çdo qartësi, çdo siguri, çdo rezistencë.

Përveç nëse për ta siguruar me të vërtetë egon mbi veten e saj, të mos duhet për të hequr dorë nga paradigma e sigurisë, që vjen nga bota dhe sillet mbi të, dhe për të braktisur në ambicjen absurde të të garantuarit të vetes sime nga vetë mua sigurinë e varfër të një ekzistence të kushtëzuar, njëlloj siç një objekt apo një qenie e botës. Në rastin tim, vetëm në rastin tim, siguria ime kërkon shumë më tepër sesa një ekzistencë të sigurtë, madje, në përgjithësi, sesa një siguri. Ajo kërkon që unë të mund ta konsideroj veten, në këtë ekzistencë, si të çliruar nga kotësia, të hequr qafe çdo dyshim kotësie, të paprekur nga « për çfarë më duhet ? ». Për të përballuar këtë kërkesë, nuk bëhet më fjalë për të arritur një siguri të qenuri, por përgjigjen ndaj një tjetër pyetje – « a më duan ? ».

Siguria u shkon përshtat objekteve dhe, më përgjithësisht, qenieve të botës, sepse të jesh, për to, është njëlloj me të qëndrosh në praninë faktike – dhe faktësia, ajo, mund të tregohet si e sigurtë. Por kjo mënyrë të qenuri nuk më shkon përshtat mua. Së pari, ajo nuk më shkon përshtat sepse unë nuk jam në masën e faktësisë sime, por të mundësisë sime ; nëse do të duhej të rrija për kohë të gjatë në gjendjen faktike ku jam, sigurisht që unë do të isha ky që jam, por do të ishte e drejtë të më merrnin për një « të vdekur » ; për të qenë ai që jam, mua më duhet përkundrazi të hap një mundësi për tu bërë tjetër nga ç'jam, për të ndryshuar në të ardhmen, për të *mos* ngulmuar në gjendjen time aktuale të të qenurit, por për tu shndërruar në një gjendje tjetër të qenuri ; shkurt, për të qenë ai që jam (dhe jo një objekt apo një qenie e botës), unë duhet të jem i tillë si mundësi, pra i tillë si mundësi të qenuri *ndryshe*. Mirëpo asnjë mundësi nuk bie në kthetrat e sigurisë – mundësia përkufizohet madje nga pathjeshtueshmëria e saj tek siguria. Pra, nga mënyra ime e të qenurit sipas mundësisë, unë nuk varem nga siguria.